



# KOLEGJI DARDANIA

Rr. "Ibrahim Lutfiu" Nr. 93, 10000 Prishtinë

Tel: +383 (0) 38 247-587 / +383 (0) 44 636-359

Web: [www.kolegjidardania.com](http://www.kolegjidardania.com)

## UDHËZUES

# PËR TEMËN E DIPLOMËS BACHELOR

Për studentët e programeve Bachelor në Fakultetet e Kolegjit Dardania

Prishtinë, 2021

## PËRMBAJTJA

1. HYRJE .....	3
2. PUNIMI I DIPLOMËS NË PROGRAMET BACHELOR .....	4
2.1 Standardet dhe procesi .....	4
3. VLERËSIMI I DORËSHKRIMIT DHE PËRSHKRIMI I NOTAVE .....	7
4. ETIKA HULUMTUESE DHE PLAGJIARIZMI .....	10
5. MODELI I PUNIMIT TË DIPLOMËS .....	14
6. TË DHËNAT TEKNIKE .....	29
7. SHTOJCA .....	32
8. KËRKESË PËR LEJIMIN E TEZËS (Modeli) .....	33

## 1. HYRJE

Punimi i temës së diplomës në nivelin Bachelor, paraqet pjesën përfundimtare të studimeve Bachelor sipas programit të planifikuar. Tema e diplomës, si fazë përfundimtare e studimeve në nivelin e parë, u mundëson studentëve të tregojnë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për organizimin dhe përfundimin me sukses të një projekti kërkimor.

Planifikimi i temës së diplomës Bachelor dhe planifikimi i kohës së realizimit të secilës fazë të punës studimore duhet të bëhet me kujdes dhe në bashkëpunim të ngushtë me mentorin përkatës të caktuar nga Këshilli mësimor i fakultetit.

Shkrimi i punimit të diplomës nënkupton angazhimin sistematik të studentit për të përmbledhur temën në gjerësinë e saj dhe për të reflektuar në mënyrë analitike dhe kritike për literaturë dhe për të formuluar tekstin e menduar dhe të formuluar drejt, duke dëshmuar shkathtësi akademike në të shkruar dhe konkluduar për punën hulumtuese në mënyrë të qartë.

Doracaku për punimin e temës së diplomës komentohet nga mësimdhënësi i cili e ligjëron lënden Punim Diplome, dhe i njëjti kërkohet të lexohet sërish para se të fillohet me dorëshkrimin e punimit dhe pastaj vijimisht gjatë gjithë procesit deri në dorëzimin e draftit të parë të dorëshkrimit. Një punë e tillë e lehtëson dukshëm punën kërkimore qoftë në kërkimin e literaturës, përpilimin e skedave të teksteve të lexuara por e mundëson poashtu edhe shfrytëzimin më efikas të kohës së konsultimeve me mentorin.

Ky doracak ofron informata të mjaftueshme dhe aktuale se çfarë standardesh duhet të posedojë dorëshkrimi, duke filluar nga abstrakti, përmbajtja dhe tërë procesi i punës, nga paraqitja e temës e deri te hartimi i projektit ideor dhe atij detal të projektpropozimit dhe punimit final të temes Bachelor. Doracaku përmbanë hollësi edhe për procesin hulumtues dhe procedurat që duhet të ndiqen deri tek mbrojtja e punimit.

Në lidhje me realizimin e pjesës empirike të hulumtimit, kandidati gjithmonë është në marrëveshje me mentorin e temës dhe ata bashkërisht i respektojnë rregullat që përcaktohen me këtë doracak, për të mos i anashkaluar rregullat specifike të këtij udhëzuesi.

Me këtë doracak përcaktohen sakt procedurat të cilat kanë për qëllim mbështetjen dhe organizimin e efektshëm të ecurisë, instrumenteve dhe procedurave të përgatitjes, mentorimit (udhëheqjes), mbrojtjes dhe vlerësimit të punimit të diplomës në fakultetet e Kolegjit Dardania në Prishtinë.

Doracaku është përpiluar me qëllim që studentëve të ua lehtësoj procedurën për orientim të drejt në përcaktimin e titullit të temës dhe të mentorit por doracaku nuk është hartuar si zëvendësim i literaturës për metodologjinë e hulumtimit, por i njëjti mund të përdoret krahas literaturës bashkëkohore metodologjike, e cila vazhdimisht ndryshon.

## **2. PUNIMI I DIPLOMËS NË PROGRAMET BACHELOR**

### **2.1 Standardet dhe procesi**

Kolegji Dardania ofron tre Fakultete të cilat ofrojnë graden Bachelor.

- Psikologji Aplikative dhe Studime Menaxheriale – 180 ECTS
- Përkujdesje dhe Mirëqenie Sociale - 180 ECTS, dhe
- Shkenca Politike dhe Administrim Publik - 180 ECTS

Kreditet që arkëtohen me rastin e mbrojtjes publike janë 6 ECTS.

Në programet e mësipërme, tema e diplomës Bachelor duhet të përshtatet me natyrën e programit përkatës dhe punimi duhet të ketë së paku 8000-9000 fjalë (30-40 faqe).

Punimi i Diplomës mund të jetë teorik, empirik ose mikst.

Secilit student i lejohet që të përgatisë dhe të dorëzojë punimin e Diplomës pasi ai/ajo t'i ketë përfunduar me sukses kurset e parapara me planin dhe programin e studimit. Studenti, në dakordim paraprak me mësimdhënësin e zgjedhur (mentorin potencial), e përpilon dhe e dorëzon kërkesën me shkrim për temën e propozuar tek Këshilli i Fakultetit. Këshilli i Fakultetit në mbledhjen vijuese e shqyrton kërkesën e kandidatit, ku tema e propozuar mund të miratohet, të modifikohet sipas natyrës së programit ose të refuzohet si e pa objekt. Në rast të refuzimit, kandidati njoftohet për arsyet e refuzimit dhe kandidati pas konsultimit me mentorin, ka të drejtë të paraqesë kërkesë të re.

Tema e propozuar nga kandidati mund t'i takojë të gjitha fushave të programit studimor por, tema duhet të jetë doemos e ndërlidhur me natyrën e fushës përkatëse studimore. Pra, nëse

studenti diplomon në Fakultetin Psikologji Aplikative dhe Studime Menaxheriale, tema duhet të përmbajë në fjalët e saj kyçe, ndonjë nga fjalët si: motivim, menaxhim, fushë personaliteti (fusha kognitive, fusha afektive dhe fusha psikomotore), inteligjencë, proces i të menduarit, të mësuarit etj. Nëse student i diplomon në Fakultetin Përkujdesje dhe Mirëqenie Sociale, tema duhet të përmbajë në fjalët e saj kyçe si: përkujdesje, mirëqenie, fëmijë me nevoja të veçanta, puna me të rritur, kompetencë (kompetenca e komunikimit, e të menduarit,) aftësitë personale, divorc, dhunë etj. Përveç kësaj, në temë krahas shqyrtimit të literaturës, duhet të paraqitet një ecuri e hulumtimit empirik (plani i kërkimit metodologjik) dhe instrumentet për grumbullimin e të dhënave nga terreni i cili ndërlidhet me temën e diplomës

Këshilli i Fakultetit ka të drejtë, të propozojë ndërrimin e mentorit, nëse konsideron se tema është më e përshtatshme për një mentor të fushës përkatëse, me qëllim të rritjes së cilësisë së punimit.

Pas miratimit të temës nga Këshilli i Fakultetit, dhe sipas afatit të përcaktuar me Rregulloren për studimet baçelor, student i mund të paraqes kërkesën për mbrojtje të temës.

Punimi i Diplomës është punë individuale e studentit dhe puna realizohet në marrëveshje dhe mbikëqyrje të profesorit mentor.

Kandidati/tja për punimin e Diplomës do të bëjë një hulumtim të pavarur për një problem të fushës përkatëse (Psikologji Aplikative dhe Studime Menaxheriale, Përkujdesje dhe Mirëqenie Sociale, ose Shkenca Politike dhe Administrim Publik), dhe këtij hulumtimi t'i paraprijë një shqyrtim i literaturës përkatëse (jo më pak se 20 referime nga libra, artikuj, broshura). Student i mund t'i referohet edhe burimeve nga interneti, por, këto shënohen si referenca të veçanta (burimet nga interneti) dhe duhet të jenë web-faqe të sigurta.

Punimi mund të jetë edhe vetëm teorik, por në këtë rast duhet të ketë literaturë më të pasur dhe të përmbushë të gjitha kriteret e përmendura më lartë. Megjithatë, rekomandohet që Punimi i Diplomës të jetë empirik ku gjatë zhvillimit të hulumtimit kandidatët duhet të demonstrojnë se janë të aftë të bëjnë hulumtim dhe të raportojnë përkitazi me tërë procesin e hulumtimit, që shpie në tekstin përfundimtar të temës së diplomës ose edhe mikst (i përzier) në rastet kur tema mund të begatohet me një hulumtim të shkurtër për të dëshmuar karakterin e tij empirik në mjedisin përkatës.

Hulumtimi i mirëfilltë gjithmonë fillon me shqyrtimin e literaturës, identifikimin e problemit të studimit dhe formulimin e qëllimit të hulumtimit (që pasohet nga variablat, pyetja/et e hulumtimit dhe hipoteza/t varësisht nga lloji i hulumtimit), definimin e metodologjisë së hulumtimit (metodat, teknikat dhe instrumentet e hulumtimit), dinamikën e hulumtimit (përgatitjen e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave, punën në terren, sistematizimin, përpunimin, analizën dhe interpretimin e tyre, për të ardhur në fazën finale të shkrimit të temës së diplomës.

Punimi i diplomës u mundëson studentëve:

- Të thellojnë dhe zgjerojnë njohuri në një lëmi/fushë të veçantë;
- Të demonstrojnë shkathtësi në kerkimin dhe shqyrtimin e literaturës relevante;
- Të përfitojnë përvojë në procesin e hulumtimeve, duke filluar nga definimi i një problemi e deri tek hartimi i një raporti të hulumtimit;
- Të tregojnë aftësi dhe përvojë në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave;
- Të demonstrojnë shkathtësi interpretimi të rezultateve hulumtimit;
- Të demonstrojnë aftësi të shkrimit për qëllime akademike.

### 3. VLERËSIMI I DORËSHKRIMIT DHE PËRSHKRIMI I NOTAVE

Dorëshkrimi i dorëzuar nga studenti bëhet pas aprovimit nga mentori i tij. Në vijim do të përshkruajmë ecurinë e vlerësimit të dorëshkrimit të punimit të dorëzuar nga studenti, i cili duhet të shërbejë si pikë referuese për notimin e përgjithshëm në të gjitha fakultetet e Kolegjit Dardania. Në procesin e vlerësimit të dorëshkrimit final në notën finale duhet të respektohen tre kritere bazë:

- nota mesatare gjatë studimeve, sipas rregullores së studimeve themelore BA;
- nota për dorëshkrimin final të temës së diplomës, dhe
- nota për aftësitë prezantuese të aspektit teorik dhe empirik të dorëshkrimit.

Kriteret për vlerësimin numërikisht janë si në vijim:

**Nota 5 (pamjaftueshëm).** Me notën 5 vlerësohet studimi për të cilin komisioni i vlerësimit konstaton se studimi i ka shkelur parimet themelore etike. Tema e studiuar nuk është relevante dhe sfondi teorik nuk është i lidhur me problemin që është objekt studimi. Punimi nuk disponon të dhëna të mjaftueshme për studimin dhe prezantimi i gjetjeve nuk lidhet me pyetjet kërkimore dhe problemin që po studiohet. Gjuha nuk është e pranueshme për shkrim akademik.

**Nota 6 (mjaftueshëm).** Me notën 6 vlerësohet studimi i cili i plotëson kërkesat minimale për temën e Diplomës në Kolegjin Dardania sipas programit të fakultetit përkatës. Sfondi i studimit është ose shumë i ngushtë ose shumë i gjerë. Qëllimi i studimit është diskutuar, në një farë mase, në pjesën e hyrjes. Megjithatë, lidhjet me teorinë dhe kërkimet e mëparshme, si dhe me praktikën nga fusha përkatëse nuk janë shpjeguar. Teoritë dhe studimet e përmbledhura janë të lidhura dobët me problemin e hulumtimit. Përdorimi i metodave të hulumtimit është i pamjaftueshëm ose jokonsistent. Prezantimi i rezultateve është sipërfaqësor apo në formë liste, dhe ka mangësi dhe mospërputhje në rezultate apo përfundime. Diskutimi është i mangët dhe nuk arrin një nivel më të përgjithshëm të interpretimit. Gjuha është mjaft e varfër.

**Nota 7 (kënaqshëm).** Me notën 7 komisioni e vlerëson dorëshkrimin kur tema është e zakonshme, arsyetimet mbi temën dhe fokusimi në temë ekzistojnë por ato janë kryesisht sipërfaqësore. Teoritë përkatëse dhe rezultatet e hulumtimit janë prezantuar në formë të taksonomike dhe në mënyrë mekanike, sfondi i paraqitur si tërësi është ose shumë i gjerë ose shumë i ngushtë. Autori është

përpjekur të lidhë pikat fillestare të studimit, si dhe qëllimin dhe problemin e hulumtimit me njohuritë e mëparshme, por nuk ka pasur sukses të mjaftueshëm. Disa nga elementet e qëllimit të hulumtimit janë relativisht dobët të lidhura me sfondin teorik, ose të njëjtat nuk merren parasysh në lidhje me rezultatet. Metodatat e hulumtimit kanë mangësi të konsiderueshme dhe nuk iu përmbahet gjithaq aspektit metodologjik. Rezultatet janë paraqitur në formë të njëtrajtshme (sipas një formule të njëjtë). Lidhja me kontekstin teorik mbetet modeste. Interpretimi i rezultateve tregon një lidhje të pikënisjes së studimit me rezultatet e mëhershme.

**Nota 8 (mirë).** Me notën 8 nga komisioni vlerësohet dorëshkrimi i cili e thekson rëndësinë e temës së zgjedhur dhe e cila është e arsyetuar mjaftueshëm qartë. Sfondi teorik i studimit është prezantuar në tërësi mirë, dhe kandidati ka bërë hulumtimin e literaturës për hulumtimet e mëparshme. Literatura e zgjedhur është aktuale dhe mjaft relevante për problemet e hulumtimit dhe literatura e huaj është përdorur si një pjesë thelbësore e studimit. Sfondi teorik i tezës apo baza praktike e fenomenit është shtjelluar dhe lidhja me problemin hulumtues është demonstruar, edhe pse jo në detaje. Zgjedhja e metodave (cilësore apo sasimore) të hulumtimit është justifikuar në një mënyrë që tregon njohuri të metodave të hulumtimit. Metodatat e zgjedhura janë aplikuar në mënyrë konvencionale, kryesisht korrekte. Interpretimi i rezultateve është i një niveli të lartë, siç janë edhe përfundimet dhe ka pasur një përpjekje për të arritur një ballans (drejtëpeshim) midis teorisë dhe gjetjeve empirike.

**Nota 9 (shumë mirë).** Me notën 9 nga komisioni i vlerësimit vlerësohet dorëshkrimi i cili trajton një temë të re, të rëndësishme, aktuale dhe interesante, problemet e së cilës janë paraqitur dhe zhvilluar në mënyrë të pavarur. Sfondi teorik dhe pikat nismëtare të studimit demonstrojnë njohje të mirë të teorisë. Problemi i hulumtimit është përshkruar saktësisht, është arsyetuar mjaftueshëm dhe është bërë lidhje e mirë me sfondin teorik. Literatura vendore dhe ndërkombëtare është përdorur në mënyrë të drejtë. Zgjedhja e metodave të hulumtimit dhe arsyetimet për këtë demonstrojnë njohuri metodologjike. Grumbullimi i të dhënave dhe ecuritë metodologjike të analizave janë përdorur me shumë aftësi dhe vlefshmëria e tyre për qëllimin e hulumtimit është vlerësuar dhe demonstruar qartë. Interpretimi i rezultateve dhe konkludimeve është logjik, i justifikuar dhe i kontribuon hulumtimit si tërësi. Gjuha dhe struktura e tezës janë koherente dhe të një niveli të lartë.



**Nota 10 (shkëlqyeshëm).** Me notën 10 nga komisioni i vlerësimit vlerësohet dorëshkrimi i cili tregon se disponon me vlera më të larta kërkuese dhe i cili në të gjitha aspektet ka vlerë të lartë apo se studimi është më i rëndësishëm se një temë mesatare. Tema tregon familjarizim të thellë të studiuesit me temë dhe kjo dëshmohet se studimi është punuar me përkushtim dhe në mbështetje të metodologjisë bashkëkohore hulumtuese. Dorëshkrimi shquhet për të menduarit e pavarur, mendimin kritik dhe mjaft deduktiv.

Dorëshkrimi përmbush plotësisht fushat e kritereve të vlerësimit si më poshtë:

- a) Strukturon drejt dhe sintetizon teorinë nga hulumtimet të mëhershme të fushës dhe arrinë që të prodhojë perspektiva të reja;
- b) Dëshmon aktualitet, rëndësi dhe inovacion në trajtimin teorik dhe dëshmon qartë qëllimin e hulumtimit;
- c) Është i fokusuar në aspektet kryciale, duke i trajtuar ato në mënyrë mjeshtrore;
- d) Metodologjia e punës kërkimore duke filluar nga zgjedhja, zhvillimi, vlerësimi dhe zbatimi i grumbullimit si dhe përpunimi dhe analiza e tyre reflekton zbatimin e metodave bashkëkohore;
- e) Dorëshkrimi dëshmon se autori ka bërë interpretim origjinal të rezultateve, dhe ka arritur të nxjerr përfundime të qëndrueshme;
- f) Ana ilustrative dhe paraqitjet grafike bashkë me përlogaritjet statistikore janë bërë mirë dhe të njëjtat janë bazë për diskutim.

#### 4. ETIKA HULUMTUESE DHE PLAGJIARIZMI

Etika e hulumtimit konsiderohet parim bazë në hulumtimet metodologjike. Etika e hulumtimit në Kolegjin Dardania konsiderohet kusht elementar dhe i domosdoshëm dhe njëherit mirret kriter parësor i vlerësimit të dorëshkrimit. Anashkalimi në çfarëdo rasti i etikës së hulumtimit mund të çojë në plagjiarizëm ose në format tjera të “huazimeve të pa autorizuara”.

Në hulumtime rëndësi e veçantë duhet t’i kushtohet edhe procedurave etike. Në të vërtetë, hulumtimet nuk ndodhin në “ndonjë ambient tërësisht steril” ku mund të kontrollohet çdo detal. Ato kryhen në mjedise të ndryshme shoqërore dhe hapësinore. Prandaj, është me rëndësi që studentët të marrin parasysh standardet e etikës profesionale dhe t’i respektojnë ato në klasë dhe në mjedisin ku kryhet hulumtimi.

Plagjiatura është njëra ndër format e mashtrimit akademik. Studentët duhet ta kenë të qartë kuptimin e nocionit plagjiaturë dhe të mënjanojnë plagjiaturën në punën e tyre gjatë studimeve.

Plagjiaturë është kur një individ përdor tekstin, citimet ose idetë e autorëve tjerë duke mos u thirrur në burimin adekuat dhe të njëjtat i shpreh në dorëshkrim sikur të ishin shprehje (mendime) të tij. Plagjiarizmi është dukuri e cila ndëshkohet rëndë në komunitetin akademik, prandaj Kolegji Dardania u kërkon studijuesve të rinjë që t’iu shmangen, meqë ekzistojnë ecuri të cilat iu mundësojnë studentëve shfrytëzimin e materialeve, ideve, rezultateve respektibile duke iu referuar burimit të secilës ide që ata përdorin në punën e tyre.

Rast tjetër i mashtrimit akademik është edhe dukuria e kompilacionit. Kompilacioni i referohet rrjeshtimit të njëpasnjëshëm të mendimeve, ideve dhe rezultateve të hulumtimit nga burimet e ndryshme, pa ndonjë ndërhyrje me mendimet të vet studentit, ndonëse citohen në mënyrë të drejtë burimet e shfrytëzuara në aspektin metodologjik. Kjo nuk konsiderohet në kuptimin burimor si plagjiaturë por as nuk preferohet të përdoret si dukuri, sepse në fund punimi nuk konsiderohet autorial. Në raste të tilla paraqiten pengesa dhe vështirësi në identifikimin e kontributit të studentit në hulumtim.

Për arsyet të cilat u listuan më sipër, është më se e domosdoshme që në çdo fazë të hulumtimeve të merren parasysh etika hulumtuese në mënyrë që të ruhet integriteti akademik.

Parimet themelore të etikës hulumtuese janë:

- Respektimi i dinjitetit njerëzor (trajtimi i personave në mënyrë të drejtë dhe respektimi i të drejtave të njeriut);
- Dobia (përpjekje për cilësi dhe përdorim më të mirë të burimeve, jo shfrytëzim i pjesëmarrësve të hulumtimit; hulumtimi bëhet për të bërë mirë dhe jo dëme);
- Korrektësia (rëndësia e paanësisë, qasje e barabartë, respektimi i autorësisë, respektimi i individëve apo i grupeve të personave me nevoja të veçanta etj).

Studentët kërkohet që gjatë gjithë procesit të punës kërkimore të respektojnë dinjitetin dhe integritetin akademik duke u përpjekur që:

- të shfrytëzojnë në mënyrë të ndershme kontributet e autorëve tjerë dhe burimet t'i shfrytëzojnë drejt në punën e tyre;
- të përfundojnë në mënyrë të pavarur punën e tyre hulumtuese;
- të iu përmbahen me pedantëri dhe në përpikmëri udhëzimeve të metodologjisë së punës hulumtuese dhe udhëzimeve të këtij doracaku;
- të respektojnë me arsye standardet e ndershmërisë akademike, dhe
- të shmangin plotësisht çfarëdo forme të pandershmërisë akademike.

Prandaj, pjesë e këtij doracaku është edhe modeli i përpilimit të deklaratës etike e cila duhet të jetë pjesë e pandashme e dorëshkrimit të tyre.

Në rast se për një punim të diplomës vërtetohet se përmbanë plagjiaturë, Këshilli mësimor i fakultetit do të marrë masat adekuate sipas Rregullores së studimeve dhe Kodit Etik të Kolegjit Dardania.

# KOLEGJI DARDANIA

## FAKULTETI – SHKENCA POLITIKE DHE ADMINISTRIM

**PUBLIK** (Shkruhet titulli i fakultetit si: Fakulteti - Përkujdesje dhe Mirëqenie Sociale,  
Fakulteti - Psikologji Aplikative dhe Studime Menaxheriale, Shkenca Politike dhe Administrim  
Publik)



# PUNIM DIPLOME

[ Titulli i punimit vetëm me shkronjë të parë të madhe]

Mentori/ja:

Prof. Dr. Emri dhe mbiemri

(nëse mentori nuk është profesor i/e rregullt = Asoc.apo Ass.)

Kandidati/ja:

Emri i Kandidatit/tes

Prishtinë, muaji VITI

Qëllimisht e lënë e bardhë

KOLEGJI DARDANIA  
FAKULTETI – SHKENCA POLITIKE DHE ADMINISTRIM  
PUBLIK



# PUNIM DIPLOME

[ Titulli i punimit vetëm me shkronjë të parë të madhe]

Mentori/ja:

Prof. Dr. Emri dhe mbiemri

(nëse mentori nuk është profesor i/e rregullt = Asoc.apo Ass.)

Kandidati/ja:

Emri i Kandidatit/tes

Prishtinë, muaji VITI

Qëllimisht e lënë e bardhë

© [viti]-[emri i autorit] Të gjitha të drejtat të rezervuara.



## **Shkurtesat / Akronimet**

(Këtu shkruhen shkurtesat të cilat hasen në dorëshkrim.)

Psh.

PMS – Përkujdesje dhe Mirëqenie Sociale.

SHPAP – Shkenca Politike dhe Administrim Publik

PASM – Psikologji Aplikative dhe Studime Menaxheriale, etj.

## **Lista e tabelave, grafikoneve dhe paraqitjeve ilustrative**

(Këtu listohen numëriksht tabelat (duke filluar nga nr.1 Legjenda, faqe) pastaj Grafikonet (duke filluar nga 1, Legjenda dhe faqe,) të cilat hasen në dorëshkrim).

Psh.

Tabela Nr.1 Paraqitja e rezultateve të punësuarve gjatë vitit 2018.....fq. 7

Tabela Nr. 2 Tabela e kalueshmërisë në lëndën Puna me të Rritur.....fq. 12

## PËRMBAJTJA

Abstrakti .....	20
Hyrje .....	21
Shqyrtim i literaturës .....	21
Qëllimi i hulumtimit .....	23
Pyetjet e hulumtimit dhe/ose hipoteza .....	24
Metodologjia .....	25
Metodat, teknikat dhe instrumentet e hulumtimit.....	25
Popullacioni dhe Mostra .....	26
Dinamika e hulumtimit .....	26
Analiza e të dhënave dhe rezultatet .....	27
Konkludimet dhe rekomandimet .....	28
Të dhënat teknike .....	29
Referencat bibliografike .....	32
SHTOJCA A: Titulli i shtojcës / shtojcave .....	33

## Abstrakti

Abstrakti konsiderohet teksti i parë autorial në dorëshkrimin e studentit. Abstrakti duhet të përmbajë deri në 350 fjalë. Pjesë përbërëse e abstraktit duhet të jenë fjalët kyçe. Numri i preferuar i tyre duhet të jetë 3 deri në 5 sosh. Të jetë maksimalisht deri në 5 terme që përfaqësojnë punimin, terme që përfaqësojnë punimin cilat duhet të renditen sipas alfabetit prej A në Zh. Fjalët kyçe janë terme që përfaqësojnë esencën e punimin e diplomës. Abstrakti bashkë me fjalët kyçe duhet të përmbledhen në më së shumti një faqe.

### *Shembull:*

Tema tashme e studijuar paraqitet përmes një abstrakti: me linjen teorike e cila e mbështet punimin.

Tekst tekst teks tekst tekst tekst tekst tekst tekst tekst tekst tekst tekst tekst

Tekst tekst tekst tekst tekst tekst tekst tekst tekst tekst.

Qëllimin e problemit të studijuar dhe rëndësinë e këtij studimi e ....

Metodologjia e vënë në praktikë (sasiore, cilësore), është ..... detaje

Popullacioni nga e cila e kemi përzgjedhur mostrën është....

Rezultatet e dala nga studimi janë ..... dhe një sqarim i shkurtër e ....

Konkluzionet deri te të cilat kemi arritur janë ..... (dy-tri formulime më reprezentative) ....

**Fjalet kyçe:** P.sh., **komunikim, përkujdesje, planifikim, rehabilitim, seancë**

(Kërkohet të renditen sipas alfabetit prej A në ZH)

## **Hyrje**

Në hyrje bëhet një paraqitje e hollësishme e rëndësisë dhe aktualitetit të problemit. Në hyrje pararaqitet esenca e problemit të hulumtimit, e formuluar qartë dhe drejt. Në vazhdim shpjegohen arsyet, që e kanë nxitur studentin për zgjedhjen e temës për hulumtim.

Në hyrje studenti duhet, përveç motiveve, aktualitetit dhe rëndësisë që e kanë motivuar për hulumtimin, në vazhdim ai duhet të përshkruaj shkurtimisht përmbajtjen e temës, në mënyrë që lexuesin e mundshëm ta motivojë për ta lexuar punimin në tërësi. Duhet ikur fjalëve të tepërta dhe shpjegimit të detajizuar.

Hyrja mund të shtrihet nga 1 deri në 1.5 faqe, e jo më tepër.

## **Shqyrtimi i literaturës**

Në këtë pjesë kandidati bënë një përshkrim të përgjithshëm të literaturës relevante varësisht nga lëmi i studimit për të cilën studenti/ja është përcaktuar. Kërkesë kryesore e kësaj pjese është se nga studenti/ja kërkohet të bëhet një përshkrim i perspektivës teorike të problemit të zgjedhur për temë diplome. Kjo punë bëhet pas skedimit të teksteve të lexuara, atëherë kur nga studenti kërkohet që temën specifike ta vendosë brenda fushës përkatëse. Kjo pjesë konsiderohet pjesa qendrore për trajtimin teorik të problemit, prandaj është e domosdoshme që të paraqiten e analizohen mendimet e autorëve të ndryshëm të cilët e trajtojnë problemin, të krahasohen idetë e tyre dhe të vlerësohen teoritë më të rëndësishme, që lidhen me temën që trajtohet.

Në këtë pjesë preferohet të bëhet një përshkrim i literaturës nga autorë të ndryshëm pavarësisht shtrirjes gjeografike, të cilët e kanë studiuar problemin nga fusha përkatëse, duke ilustruar hollësisht burimet përkatëse teorike apo edhe krijimtaria e tyre hulumtuese (monografi, libra, artikuj, raporte hulumtuese, etj.), duke u përqendruar thelbësisht në gjetjet e tyre.

Duhet patur kujdes që burimet e konsultuara (monografi, libra, artikuj, raporte hulumtuese, etj) duhet të jenë jo më të vjetra se dhjetë vjet dhe të njëjtat analizohen fillimisht. Mund të ketë raste kur analizohen edhe burime më të vjetra se dhjetë vjet, varësisht nga tema e cila trajtohet dhe

reputacioni i autorit të tekstit në të cilin thirremi. Me rastin e shqyrtimit të literaturës studenti kerkohet që t'a qartësojë se çfarë dihet në burimet e analizuara, çfarë është e rëndësishme të analizohet, cilat aspekte janë trajtuar plotësisht dhe çfarë kërkon që të studiohet edhe në mënyrë sistematike. Në fund të kësaj pjese studenti/ja konstaton se cilat aspekte kanë mbetur pa përgjigje përkatëse.

Në këtë pjesë studenti/ja vëhet në pozitën e analistit krahasues, duke e vendosur problemin e tij në kontekst të “fushës së studimit”, “rrymës teorike që përfaqëson” mbi bazën e paradigmave dhe koncepteve teorike që analizon, e të cilat pritet se do t'i qartësojë gjerësisht hulumtimi i tij. Kësisoj, ky kapitull duhet të përfshijë një analizë të thukt krahasimtare të burimeve nga literatura e përzgjedhur, qoftë të teorive specifike të autorëve meritor, qoftë të përfaqësuesve të rrymave të ndryshme shkencore, të monografive relevante apo raporteve hulumtuese.

Në dorëshkrim preferohet të aplikohet stili APA i citimit, parafrazimit, citimit të drejtpërdrejt qoftë citimit të tërthort (indirekt).

Stili APA i citimit bëhet sipas ecurisë si vijon:

Mbiemri i autorit dhe viti i publikimit të cilat random futen në kllapa. Shembull: Terapia individuale minimizon përdorimin e substancave, ndërtimin e aftësive, përmirëson marrëdhëniet familjare. Gjithashtu ruan konfidencialitetin dhe ofron përforcim social (Sarra, 2015).

**Citimi direkt** përmes citimit me kllapa. Shembull: ... punonjësit socialë të shkollës shërbejnë si menaxherë të rasteve për fëmijët me aftësi të kufizuara duke bashkëpunuar me prindërit, mësuesit, stafin mbështetës, psikologët e shkollës dhe mbështetje të tjera nga profesionistë të tjerë” (Comegys & Guggemos, 2014).

**Citimi indirekt** bëhet me autorin si pjesë të tregimit, psh. ... atëherë mund të themi LaRue (2007) identifikoi lirinë intelektuale dhe sjelljen e konfidencialitetit si dy vlera kyçe, të cilat janë mbajtur historikisht nga libraritë.

**Citim i drejtpërdrejtë me kllapa:** Galtung (1990) argumenton se “proceset e negociatave duhet të përfshijnë diskutime të vazhdueshme dhe konstruktive, në lidhje me çështjet teknike dhe politike, përmes të cilave dy ose më shumë palë kërkojnë një zgjidhje në lidhje me kërkesat e tyre kontradiktore” (Galtung, 1990, cituar në Ramsbotham, Woodhoues dhe Miall, 2011, f.32).

**Citim i drejtpërdrejtë me autorin** si pjesë e tregimit: Shtetet anëtare të BE-së dëshirojnë të sigurojnë që standardet e BE-së të miratohen dhe zbatohen në shtetet e Ballkanit Perëndimor (Jacoby dhe Meunier, 2010, fq.2012).

Brenda tekstit mund edhe të citojmë burime dytësore. Janë ato burime, të cilat ne i citojmë nga një punim tjetër tërthorazi, të cilin e lexojmë dhe hasim në një citim që mund të na interesojë. Pra, në këto raste duhet të përmenden të dyja burimet edhe i pari edhe dytësi.

Në shembullin në vijim: Është menduar shumë rreth asaj se si të përkufizohet koncepti i cilësisë, por një rishikim i gjerë i literaturës së botuar në fushën e sigurimit të cilësisë (Di Biase, R., & Maniku, A. A., 2019), (Essel, H. B., Boakye-Yiadom, M., & Kyeremeh, F. A., 2018), (Geda, 2014), (Kahsay, 2012) dhe (Waheed, 2013) dokumentuan se nuk ekziston asnjë konsensus apo qartësi e vërtetë për konceptin e cilësisë në arsim.

Pastaj në fund, në faqen e referencave bibliografike, duhet të citohet burimi dytësor, i cili është lexuar nga ju, e jo ai studimi origjinal, shih shembullin në vijim.

Megjithatë, qeveria nuk ka arritur të zhvillojë politika koherente dhe të ofrojë stimuj të duhur për të tërhequr investime të tilla (Pula, Loxha dhe Elshani, 2017).

### **Qëllimi i hulumtimit**

Kah fundi i HYRJES, e paralajmërojmë qëllimin e hulumtimit, pasi të jetë bërë e qartë korniza teorike mbi të cilët ndërtohet studimi.

Qëllimi i hulumtimit preferohet të përkufizohet shkurt, qartë, saktë dhe mirë. Qëllimi i hulumtimit buron nga studimi por ndodhë që hulumtimi ka më shumë qëllime. Në këtë rast, ato duhet të jenë të harmonizuara me çështjen bosht që është studiuar. Parashtrimi i problemit, qëllimi/qëllimet apo relevanca e tij duhet të jetë e lidhur me aktualitetin dhe me perspektivën teorike të problemit i cili studiohet, dhe ai duhet përvijuar edhe me pyetjen/pyetjet e hulumtimit, hipotezat dhe metodat, teknikat dhe instrumentet e parashikuara të kërkimit empirik.

## Pyetjet e hulumtimit dhe hipoteza

Pyetja/pyetjet e hulumtimit dhe hipoteza/hipotezat e hulumtimit kërkohet të jenë origjinale dhe të njëjtat duhet të formulohen drejt, qartë dhe të jenë të lidhura me problemin i cili hulumtohet. Ato kërkohet të formulohen në atë mënyrë që të mundësohet kontrollimi dhe verifikimi i tyre.

Pyetja e hulumtimit duhet të formulohet qartë dhe duhet të sigurojë një përvijim premtues të hetimit në lidhje me një problem të caktuar, ose çështje të interesit arsimor. Parashtrimi i drejt i pyetjeve të hulumtimit ka raste kur mund të implikojë nevojën e ngritjes së një hipoteze të hulumtimit (veçmas kur është fjala për studimet e natyrës sasiore), të cilat mundësojnë verifikimin e tyre. Edhe hipoteza/hipotezat e hulumtimit duhet të jetë e formuluar drejt, saktë e qartë, sepse ato nuk guxojnë të jenë sygjestive, të dykuptimshme, asnjënjëse etj., sepse hipoteza e cila nuk mund të verifikohet në ndonjë mënyrë të caktuar, nuk mund të jetë hipotezë.

Natyra e hulumtimeve empirike kërkon që ato duhet të lidhen me fenomene të vëzhgueshme apo matshme. Studenti duhet të jetë i informuar për instrumentet të cilat varësisht nga teknikat e përzgjedhura mundësojnë matje të tilla. Hartimi i kriterëve të qarta mundëson verifikimin e hipotezës/hipotezave, qoftë duke e konfirmuar qoftë duke e mohuar vërtetësinë e saj.

Hulumtimet cilësore (kualitative) për nga natyra janë më komplekse, sepse ato kryesisht janë dukuri të vëzhgueshme por rrallë janë të matshme. Për hulumtimet cilësore është e rëndësishme që të kuptohen drejt dukuritë e hulumtimit dhe të tregohet se përvojat që reflektojnë nga ato, janë të tilla, që pasqyrojnë të kuptuarit dhe lejojnë rrjedhime të mëtejme.

Në metodologjinë shkencore përmenden edhe hulumtimet mikste ose hulumtimet e përziera (cilësore dhe sasiore). Hulumtimet mikste karakterizohen me përzierje të të dyja grupeve të metodave. Për këtë arsye, në hulumtime të tilla është e rëndësishme të përcaktohen qartë kriteret përmes së cilave hipoteza/hipotezat konfirmohet ose refuzohet.

Shembull i mirë i pyetjeve hulumtuese dhe qëllimeve mund të jenë:

Pyetjet e hulumtimit? Shembuj:

- A ndikojnë kualifikimet e validuara nga MASHT në ngritjen e cilësisë në shkollat e nivelit SHMU?



- A ekzistojnë dallime në sigurimin e cilësisë në mësimdhënie mes kualifikimeve të validuara dhe atyre të pavaliduara në SHMU?
- A ka ndërlidhje midis rezultateve të nxënësve në fushën e shkencës dhe ambientit të tyre mësimor në familje?

Hipoteza/Shembuj:

- Hipotezat e mëposhtme u formuluan për këtë punim kërkimor:
- Procesi i validimit të kualifikimit ka ndikim të ndjeshëm në ngritjen e cilësisë në shkollat e nivelit të SHMU.
- Ekzistojnë dallime në sigurimin e cilësisë në mes kualifikimeve të validuara dhe atyre të pa validuara në SHMU.
- Ekziston ndërlidhje e ngushtë afirmative midis rezultateve të nxënësve në fushën e shkencës dhe ambientit të tyre mësimor në familje?

## **Metodologjia**

Nga praktika akademike në Kolegjin Dardania rezulton se një pjesë e temave të diplomave në studimet e nivelit BA mbështeten më pak në metodologjitë kërkimore sfiduese. Me rastin e përkufizimit të metodologjisë, përgjithësisht studentët duhet shkurt, qartë dhe me dy-tri periudha të përshkruajnë natyrën e hulumtimit empirik jo-eksperimental, bie fjala: cilës natyrë sipas metodave të parapara, teknikave dhe instrumenteve të parapara, i përket hulumtimi (hulumtim i natyrës cilësore (kualitative), sasiore (kuantitative) apo hulumtimi ka karakter të përzier (mikst).

### **Metodat, teknikat dhe instrumentet e hulumtimit**

Në këtë pjesë student/ja duhet me një ose dy paragrafë të përshkruaj se me cilin grup të matodave, teknikave dhe instrumenteve do të shërbehet në hulumtimin e tij empirik jo-eksperimental.

### **a/ Metodatat e hulumtimit**

Këtu rëndom listohen disa prej metodave me të cilat synon të shërbehet për studimin e problemit të tij të hulumtimit. Psh. Metoda e analizës teorike, metoda krahasuese, metoda historike, metoda e studimit të rastit, etj.

### **b/ Teknikat e hulumtimit**

Këtu rëndom listohen disa prej teknikave me të cilat synon të shërbehet për studimin e problemit të tij të hulumtimit. Psh. Anketimi, intervistimi, të vërejturit, etj.

### **c/ Instrumentet e hulumtimit**

Këtu listohen disa prej instrumenteve, varësisht prej teknikave të përzgjedhura e të cilat i kanë edhe instrumentet përkatëse. Psh. Pyetësoi/kuestionari, protokollit i intervistimit, protokollit i vëzhgimit, etj.

Instrumentet e plota rëndom i bashkëngjiten dorëshkrimit në Shtojca.

## **Popullacioni dhe Mostra / Pjesëmarrësit**

Në këtë pjesë përshkruhet popullacioni për të cilin syzohet se disponon me informata për problemin tuaj të studimit. Psh. Nëse problemi është nga fusha e arsimit fillor, popullacioni përbëhet nga të gjithë mësuesit e arsimit fillor në Republikën e Kosovës, i cili numërisht është i madh (mbi trembëdhjetëmijë sish).

Në pamundësi të përfshihen të gjithë, sepse ka kosto financiare (numri i madh i pyetësorëve), teknike (përpilimi dhe shumëzimi i tyre), kohore (koha e gjatë për distribuim dhe analizim) dhe financiare (udhëtimi, ushqimi etj.) atëherë studenti/ja në bashkëpunim me mentorin përcaktohen për mostrën/kampionin.

## **Mostra / kampioni**

Mostra numërisht duhet të jetë e përcaktuar varësisht nga numri i popullacionit. Popullacioni i madh, mostra përfaqësuese kërkohet të jetë më numërike, popullacioni numërisht më i vogël, edhe mostra ose grupi reprezentativ do të jetë më i vogël (modest).

Nëse supozojmë se grupin e studimit për hulumtimin tonë e përbëjnë 60 punonjës socialë në territorin e komunës së Prishtinës, atëherë duhet të shpjegohen edhe karakteristikat tjera të popullacionit (sa % janë meshkuj, sa % janë të gjinisë femërore, sa janë të punësuar në qytet, sa janë të punësuar nëpër fshatra, cila është struktura e tyre moshore sipas klasave, bie fjala prej 18-30 vjeq; mbi 30-40 vjeq, mbi 40-50 vjeq, etj. Pra këto janë karakteristika specifike – variabla, të cilat kërkohet të specifikohen në këtë pjesë.

### **Procedura**

Shpjegohet saktësisht se si ka qenë renditja e ndodhive, prej ndërtimit të instrumenteve, deri te identifikimi i pjesëmarrësve dhe mbledhja e të dhënave përmes instrumenteve të ndryshme.

### **Dinamika e hulumtimit**

Në këtë pjesë ofrohet në formë tabele një dinamikë/kalendar i aktiviteteve të grupëzuara sipas dinamikës kohore e shpërndar në muaj. Psh.

Nr.	Aktiviteti	
1.	Propozimi i tre titujve dhe konsultimi me mentorin	Mars, 2022
2.	Përpilimi i projektit ideor	Prill, 2022
3	Grumbullimi dhe skedimi i literaturës	Maj, qershor, 2022
4.		

### **Analiza e të dhënave dhe rezultatet**

Kjo pjesë paraqet pjesën e dytë por njëkohësisht pjesën më origjinale të tërë punës studimore të studentit. Në këtë seksion, shpjegohet në detale mënyra dhe/apo programi softwerik i cili është aplikuar për të bërë analizën e të dhënave nga hulumtimi në terren. Nëse të dhënat janë sasiore (kuantitative), mund të bëhen analiza të ndryshme, si për shembull, analiza e të dhënave u realizua

përmes SPSS version 16, përmes një analize të krahasimit të mesatareve të subjekteve të punësuar në vitet 2020 dhe 2021 dhe 2022.

Vriabla e varur në këtë rast janë numri i kandidatëve sipas niveleve të kualifikimit (niveli 5, niveli 6, niveli 7 dhe niveli 8 i Kornizës së Kualifikimeve në Republikën e Kosovës, ndërsa variabla e pavarur është gjinia, mosha, mjedisi socialë etj...

Këto analiza duhet të paraqiten me grafikë (histogram, pitogram, etj.) ose tabela.

Gjatë analizës së të dhënave preferohet të jipet informacion sipas aspekteve të parapara me metodologjinë e hulumtimit dhe sipas pyetjeve të parashtruara në instrumentet për grumbullimin e të dhënave, por nuk është e domosdoshme të paraqiten grafikisht të gjitha rezultatet nga të dhënat në tabela dhe figura, sepse ato shpesh mund ta ngarkojnë dorëshkrimin.

Studenti/ja duhet të përfshijë vetëm rezultatet më karakteristike të studimit të cilat ndërlidhen me pyetjet e hulumtimit dhe me hipotezën e hulumtit, të cilat duhet të jenë të arsyetuara qartë dhe bindshëm nga student/ja. Ai vet kërkohet që të përcaktohet për formën e tij të preferuar të cilën e arsyeton shkurtimisht. Në rastet kur ka më shumë të dhëna, për të mos e ngarkuar pjesën, studentit/ës i lejohej që rezultatet më të detajuara t'i vendosë në shtojcat përkatëse.

### **Konkludimet dhe Rekomandimet**

Pasi të kryhet pjesa Analiza e të dhënave dhe rezultatet, duhet të formulohen disa paragrafë të cilët në formë përmbyllëse paraqesin disa nga "gjetjet kryesore të hulumtimit, të cilat ofrohen në formë konkluzionesh përfundimtare të dorëshkrimit. Zakonisht, ato jipen në formë taksative dhe nuk preferohet të jenë shumë dhe të përsëriten konstatimet e ofruara në tekstin bazë. Është me rëndësi por të elaborohet në mënyrë narrative konkludimi që është arritur në lidhje me qëllimin, pyetjet kërkimore dhe hipotezat që janë ngritur në fillim të studimit. Konkludimet në fakt duhet të shprehin shkurt, qartë dhe drejt kontributin shkencor të studimit, ose edhe kufizimet e hulumtimit, nëse ato janë paraqitur.

Në pjesën vijuese të faqes studenti ofron rekomandimet përkatëse për secilin konkludim të dhënë, i cili rekomandim iu adresohet palëve të interes të përfshira në hulumtim. Për konkludimet ose përfundimet e nxjerra, mund të jepen rekomandime përkatëse për palët e interesit.

## **6. TË DHËNAT TEKNIKE:**

### **Referenca**

Referencat janë pjesë e pandashme e listimit të burimeve të shfrytëzuara. Rëndom, janë të njohura dy ecuri të evidentimit të referencave. Ato janë: APA (American Psychological Association) dhe MLA (Mother Language Association). Kandidati mund të zgjedh nga ato të dyja njerën sosh. Me rastin e përcaktimit të ecurisë gjatë hartimit të punimit të tij studentit i kërkohet t'i përmbahet me konsekuencë. Nuk tolerohet në aspektin metodologjik përdorimi herë i njëjës e here i tjetrës ecuri brenda një dorëshkrimi. Vendosja e referencave – Rreshti i parë i çdo reference të re, duhet të jetë me një margjinë 0,5 majtas. Të gjithë rreshtat tjerë, duhet të jenë të formatizuara në fillim të margjinës së majt. Citimet e parafrazimet duhet të bëhen sipas standardit të APA-s (American Psychological Association) sepse Kolegji Dardania preferon atë ecuri.

Në referenca bibliografike futen vetëm burimet që janë cituar diku në tekst dhe jo materialet që janë shfrytëzuar për lexim të përgjithshëm. Ja disa shembuj të huazuar nga botimi i 6-të i APA-s për format e citimit.

### **Referenca për libër**

Ecuria: mbiemri dhe emri i autorit, viti i botimit, titulli i librit, vendi i botimit dhe botuesi.

Një autor/shembull:

Salihu, A. (2012). Inovacioni, shoqëria e informacionit, politikat sociale dhe shëndetësore. Prishtinë: Ministria e Integrimit European.

Autorësi e përbashkët dhe i publikuar nga një botues

Shembull:

Growling, E., Hoti, D., Kacapor, S., (2008). Mozaik – A multicultural and bilingual approach to preschool education, Manual for Educators and Parents, Prishtinë “Save The Children”.

Salihu, L., Zabeli, N., Hoti, D., (2006), Të drejtat e fëmijëve dhe etika e arsimit, Prishtinë, KEC & Save the Children.

Autor anonim

Dorland's illustrated medical dictionary (31st ed.). (2007). Philadelphia, PA: Saunders.

## Kapitull libri

Hoti, D., Teacher Education in Kosovo, (2006), The Prospects of Teacher Education in South-east Europe:” CEPS” (Centre for Educational Policy Studies), Ljubljana,

Booth-LaForce, C., & Kerns, K. A. (2009). Child-parent attachment relationships, peer relationships, and peer-group functioning. In K. H. Rubin, W. M. Bukowski, & B.

## Referencat bibliografike

Gjithmonë referencat vihen në një faqe të re. Hapësira mes rreshtash – duhet të jetë 1.5.

Vendosja e referencave –

Rreshti i parë i çdo reference të re, duhet të jetë me një margjinë 0,5 majtas. Të gjithë rreshtat tjerë, duhet të jenë të nxjerrë në kryeradhë (indent) pesë hapësira të bardha ose me një tab. të vendosur në 0,5 inch djathtas.

Radhitja e referencave – sipas rendit alfabetik të mbiemrit të autorit të parë dhe nëse ka më shumë se një reference për një autor, atëherë kjo bëhet në bazë të viteve të publikimit, duke filluar nga botimi më i ri deri te më i vjetri.

Në qoftë se një autor ka më shumë se një publikim në të njëjtin vitë atëherë, pranë vitit të publikimit vendoset shkronja a ose b, brenda kllapave.

Laursen (Eds.), Handbook of peerinteractions, relationships, and groups (pp. 490-507). New York, NY: Guilford Press.

Document nga ERIC

Shyyan, V., Thurlow, M., & Liu, K. (2005). Student perceptions of instructional strategies: Voices of English language learners with disabilities. Minneapolis,

MN: National Center on Educational Outcomes, University of Minnesota. Retrieved from the ERICdatabase. (ED495903)

Referenca për Revista Shkencore dhe gazeta në versionin e printuar

Një autor

Baliqi, B. (2017). The Aftermath of War Experiences on Kosovo's Generation on the Move- Collective Memory and Ethnic Relations among Young Adults in Kosovo. Zeitgeschichte, 6 - 19.

Nga dy autorë

Manna, P., & McGuinn, P. (2013). Education Governance for the Twenty-First Century: Overcoming the Structural Barriers to School Reform. Washington, D.C: Brookings Institution Press.

Nga 3 deri në shtatë autorë (rendit të gjithë autorët) / grup autorësh

Yager, J., Andersen, A., Devlin, M., Egger, H., Herzog, D., Mitchell, J., . . . Zerbe, K. (2000). Practice guideline for the treatment of patients with eating disorders, second edition. *American Journal of Psychiatry*, 697–766)

Revistë javore

Mathews, J., Berrett, D., & Brillman, D. (2005, May 16). Other winning equations. *Newsweek*, 145(20), 58-59.

Artikull i gazetarisë pa autorë dhe renditje të çrregullt

Generic Prozac debuts. (2001, August 3). *The Washington Post*, pp. E1, E4.

Artikuj të marrë nga burime on-line

QPM. (2022, September 13). qpm.uni-pr.edu. Marrur nga: <https://qpm.uni-pr.edu/Al/lajmet/119/planifikimi-dhe-implementimi-i-mesimdhenies-ne-arsimin-e-larte/>

Artikull nga një revistë on-line

Donald Grey Triplett, (lindur shtator 1933, Forest, Mississippi, SHBA), ishte femija i parë amerikan që ishte diagnostikuar me autizëm, ku prindërit e tij kishin vënë re se ndërveprimi social ishte sfidues dhe jo interesant për të, dhe se ai fiksohej në disa lloje objektesh dhe shfaqti një aftësi për të mësuar përmendësh.” (Nxjerrë nga: <https://www.britannica.com/biography/Donald-Triplett>, 27/08/2022)

Raporte on-line nga organizata joqeveritare

UNDP. (2022, June 5). Human Development Index - United Nations Development Programme. Gjetur në <https://hdr.undp.org/>: <https://hdr.undp.org/data-center/human-development-index#/indicies/HDI>

Raporte on-line pa autorë të identifikuar apo edhe pa datë

GVU's 10th WWW user survey. (n.d.). Retrieved from [http://www.cc.gatech.edu/user\\_surveys/survey-1998-10/4](http://www.cc.gatech.edu/user_surveys/survey-1998-10/4)

Web Site/ Web faqe me citim në kllapa

Për ta cituar një Web faqe të tërën (dhe jo një dokument të veçantë brenda saj), mjafton të vendosim URL-në e webit në tekst.

## REFERENCAT BIBLIOGRAFIKE

APA (2009) Publication Manual of the American Psychological Association, 6th ed.

American Psychological Association. Washington, DC.

LaRue, J. (2007). The new inquisition: Understanding and managing intellectual freedom challenges. Libraries Unlimited.

## 7. SHTOJCA

Në pjesën Shtojca, duhet vendosur të gjitha pjesët të cilave iu kemi referuar apo i kemi përdorur gjatë hulumtimit. Mund të ketë më shumë sosh. Për tu dalluar nga njëra – tjetra, atyre iu vendoset edhe atributi, bie fjala. Shtojca A (shënohet titulli), pra shtojcat apo anekset duhet radhitur me shkronja e jo me numra.

Në rastet kur keni vetëm një shtojcë/aneks, atëherë titulli nuk preferohet të përmbajë ndonjë shkronjë, shkruhet vetëm

Shtojca – Pyetësi (titulli i tij).

(Shtojca ashtu sikurse edhe referencat, duhet t’i përmbahen specifikave të margjinave si edhe i tërë teksti i punimit. Çfarëdo materiali tjetër qoftë i skenuar, i fotokopjuar apo i printuar për nevoja të dorëshkrimit, bashkë me lejen nga autoritetet për marrjen e pëlqimit për kryerjen e hulumtimit, duhet t’i përshtaten margjinave të faqes).

Në shtojcë nuk duhet të përfshihen materiale të parapublikuara ose materiale të cilat janë përgatitur për botim. Nëqoftë se në shtojcë megjithatë, përfshihet ndonjë material i para-publikuar ose jo-publikuar, i cili ende nuk është në zotërim publik, atëherë për të njëjtin kërkohet të sigurohet leja për përdorim dhe publikim të tij i cili duhet të përfshihet në shtojcë gjithësesi.





## KOLEGJI DARDANIA

Rr. "Ibrahim Lutfiu" Nr.93 10000 Prishtinë  
Tel: +381 (0) 38 247-587 / +377 (0) 44 636-359  
Web: www.kolegjidardania.com

### KËRKESË PËR LEJIMIN E TEMËS SË DIPLOMËS NË NIVELIN E STUDIMEVE BAÇELOR

Këshillit të Fakultetit: \_\_\_\_\_  
(Shëno emrin e programit që keni studiuar)

Titulli i temës së popozuar: \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
(Shëno temën) "tema të përshtatet me natyrën e programit të fakultetit përkatës"

Profesori mentor i propozuar: \_\_\_\_\_  
(Emrin, Mbiemrin dhe graden shkencore të profesorit)

Lënda: \_\_\_\_\_

Viti aktual akademik \_\_\_\_\_ Viti akademik i regjistrimit \_\_\_\_\_

Studenti/ja: \_\_\_\_\_  
(Shëno emrin dhe mbiemrin)

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_ Numri i tel. kontaktues: \_\_\_\_\_

Prishtinë, më \_\_\_\_\_  
(Data, Muaji, Viti)